



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:107939  
Datë: 11.03.2025  
Numri i dokumentit: 06972029

**Ac.nr.3300/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.H, L.M, A.O, G.O dhe SH.D që të gjithë nga Mitrovica, të cilët sipas autorizimit me shkrim i përfaqëson Leutrim Ademi, avokat nga Komuna e Mitrovicës, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Arbnor Murturi, me objekt kontesti “Kompensimit ne emër te ushqimit në punë (shujtave ditore) dhe diferencës së inflacionit në pagë”, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.690/2021 të datës 12.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2025 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.690/2021 të datës 12.04.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin, C.nr.690/2021 të datës 12.04.2023, në pikën I të dispozitivit,

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.H, L.M, A.O, G.O dhe SH.D që të gjithë nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve:

F.H

- Në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) për periudhën kohore 12.03.2020 e deri më datë 21.01.2021, për 69 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) euro;
- Në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 135.70(njëqind e tridhjetë e pesë e shtatëdhjetë cent) euro.

#### L.M

- Në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) për periudhën kohore 12.03.2020 e deri më datë 21.01.2021, për 69 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) euro;
- Në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 140.42 (njëqind e dyzet euro e katërdhjetë e dy cent) euro;

#### A.O

- Në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) për periudhën kohore 12.03.2020 e deri më datë 21.12.2020, për 70 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) euro;
- Në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 129.42 ( njëqind e njëzetë e nëntë e dyzet e dy cent)euro.

#### G.O

- Në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) për periudhën kohore 12.03.2020 e deri më datë 21.01.2021, për 69 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) euro;
- Në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 134.52 (njëqind e tridhjetë e katër e pesëdhjetë e dy cent) euro.

#### SH.D

- Në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë (shujtave ditore) për periudhën kohore 12.03.2020 e deri më datë 21.01.2021, për 69 ditë pune (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro), t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 138.00 (njëqind e tridhjetë e tetë) euro;
- Në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 136.76 (njëqind e tridhjetë e gjatë e shtatëdhjetë e gjashtë cent) euro.

Secilit paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8 për qind, duke llogaritur për shujta ushqimore nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë 02.06.2021, e deri në pagesën përfundimtare, dhe për kompensim të inflacionit nga dita e zgjerimit të padisë datë 20.04.2022 të gjitha këto (borxhin

kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- III. OBLIGOHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia kompensoj paditësve shumën në lartësi prej 1,648.80 € (njëmijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, dhe ta ndryshoj aktgjykimin C.nr.690/21 të datës 12.04.2023 si dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve, dhe të anulohet aktgjykimi C.nr.690/21 i datës 12.04.2023 dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë kanë parashtruar paditësit duke i propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e të paditurës si dhe kërkojmë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë, në shumën prej 312.00euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

***-Ankesa e të autorizuarit të paditurës është e pathemeltë.***

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Paditësit F.H, L.M, A.O, G.O dhe SH.D të cilët gjithë të punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "I.Q" në Mitrovicë, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 02.06.2021 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të precizuar me parashtrësat e datës 27.03.2023, me të cilën ka kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë (për secilën ditë të pranisë në punë nga 2 euro) si dhe kompensimin në emër të inflacionit-diferencës në pagë, për të gjithë paditësit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 për qind, duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 18.04.2017 (tutje si KKAK).

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të çështjes në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.690/21 i datës 12.04.2023 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Pas administrimit të provave, gjykata gjeti se nuk ishte kontestuese fakti se paditëset janë të punësuar tek e paditura, pasi që kjo u vërtetua nga Vërtetimi në emër të paditësës F.H e lëshuar nga shkolla fillore "I.Q", i datës 15.06.2022 për ditët e prezencës në punë, Vërtetimi në emër të paditësës L.M, e lëshuar nga shkolla fillore "I.Q", i datës 15.09.2022 për ditët e prezencës në punë, Vërtetimi në emër të paditësës A.O, e lëshuar nga shkolla fillore "I.Q", i datës 15.09.2022 për ditët e prezencës në punë, Vërtetimi në emër të paditësës G.O, e lëshuar nga shkolla fillore

“I.Q”, i datës 15.09.2022 për ditët e prezencës në punë, Vërtetimi në emër të paditëses SH.D, e lëshuar nga shkolla fillore “I.Q”, i datës 15.09.2022 për ditët e prezencës në punë;

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur ne dispozitën e nenit 449, 452 dhe 463 par.1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, pasi që e paditura në rastin konkret ka humbur procesin dhe për këtë arsye vendosi si me anë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet dhe faktet vendimtare te theksuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendimet të autorizuarit të të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se paditëset janë të punësuara tek e paditura në shkollën Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “I.Q” në Mitrovicë ku vërtetohet në bazë të kontratës së punës e lëshuar nga e paditura, ditët e pranisë në punë për periudhën kontestuese të cilat janë vërtetuar përmes vërtetimit të punësimit për secilin paditës veç e veç, si dhe lartësia e pagës e cila është vërtetuar përmes listës së pagave për secilin paditës, e nisur nga kjo gjykata shkallës së parë drejtë ka vendosur që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve duke u bazuar në nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin në paragrafi 7 të KKAK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjate punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të*

*punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin*". Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësës.

Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Lidhur me pretendimet ankimore me zbatimin e gabuar të dispozitave të drejtës materiale, si në pikën dy (II) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi pasi që ka vlerësuar se një kërkesë e tillë gjen mbështetje në KKAK, e cila në nenin 35 paragrafi 10 ka përcaktuar se: "*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*". Nga interpretimi i kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e njëjta dispozitë është detyruese për të paditurën andaj edhe e ka detyruar të njëjtën për pagesën e inflacionit për periudhën kohore të precizuar nga i autorizuari i paditësve përkatësisht për periudhën kohore nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020.

Lidhur me lartësinë e kompensimit sa i përket inflacionit, gjykata ka vendosur duke u bazuar në ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti gjyqësor ashtu që paditësen e parë F.H në emër të kompensimit për inflacion për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 135.70 (njëqind e tridhjetë e pesë e shtatëdhjetë cent) euro, për paditësen e dytë: L.M për kompensimin në emër të inflacionit për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 140.42 (njëqind e dyzet euro e katërdhjetë e dy cent) euro, për paditësen e tretë Ardita Olshani, për kompensimin në emër të inflacionit për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 129.42 (njëqind e njëzetë e nëntë e dyzet e dy cent) euro; për paditësen e katërt G.O, për kompensimin në emër të inflacionit për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 134.52 (njëqind e tridhjetë e katër e pesëdhjetë e dy cent) euro; për paditësin e pestë SH.D, për kompensimin në emër të inflacionit për periudhën nga data 20.04.2019 deri me datë 30.12.2020, t'ia paguaj shumën prej 136.76 (njëqind e tridhjetë e gjatë e shtatëdhjetë e gjashtë cent) euro.

E drejta e paditësve gjen mbështetje edhe me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*". gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, andaj lidhur me pretendimet ankimore të paditurës, për kompensimin e udhëtimit dhe kualifikimit, Gjykata e Apelit i vlerësoj si pretendimet të pathemeltë dhe pa ndikim për vendosje ndryshe në kontestin në fjalë, për të njëjtat shkaqe

vlerësoj se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar vlerësohet si rregullt dhe i drejtë.

Në raport me pretendimin ankimor të të paditurës se kontrata kolektive në të cilën janë thirrur paditësja dhe gjykata dhe konsiderimit se kjo kontratë është në kundërshtim me Ligjin e punës dhe se Komuna e Mitrovicës si punëdhënëse e paditësve nuk është nënshkruese e kësaj Kontrate kolektive, Gjykata e Apelit e refuzon si të pa themeltë një pretendim të tillë për shkak se me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: “... Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet...”, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimin tjetër ankimor të paditurës lidhur me atë se gjatë periudhës kontestuese, paditëset nuk kanë qenë të pranishme në punë për shkak të pandemisë Covid – 19, mirëpo pas vlerësimit të shkresave të lëndës të njëjtin e gjeti si të pabazuar, kjo sepse është vet e paditura ajo e cila paditësve i ka lëshuar vërtetimin për ditët e pranisë në punë gjatë periudhës kontestuese, përmes të cilës është vërtetuar fakti me peshë vendimtare në këtë çështje juridiko – kontestimore, pra i njëjti pretendim është në kundërshtim me vetë shkresën të cilën e ka lëshuar e paditura.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të përfaqësuesit të paditurës, të njëjtat u vlerësuan si pretendimet të karakterit deklarativ dhe jo argumentuese, çka dhe në kuptim të kësaj rezulton se aktgjykimi i atakuar është i arsyetuar si për nga baza ligjore po ashtu edhe nga rrjedha logjike me dispozitivit dhe provat e administruara, çka dhe rezultoj se pretendimet e të paditurës ishin pa ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3300/2023, me datë 10.03.2025**

**Kryetar i Kolegjit - Gjyqtari**  
***Faton Ademi d.v***